Kronikë

E rëndë në Elbasan/ Po i vinte eksploziv një makine, i shpërtheu në dorë, vdes 25-vjeçari! Identifikohet kush ishte shënjestra! Shkak një konflikt i vjetër (EMRAT+VIDEO)

Kristi Balukja, 25 vjeç, humbi jetën mëngjesin 29 tetorit në Elbasan. Teksa po tentonte të vendosë një sasi eksplozivi në një makin lënda i shpërtheu në dorë para kohe.

■ Humbi jetën pasi po i vendoste eksploziv një makine por i shpërtheu, ja pamjet nga mjeti i dëmtuar (VIDEO)

[Sh].com Lajmi i fundit

Manchester United zgjedh trajnerin e ri

30 Tetor, 13:39

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh].com Redaksia
29 Tetor, 07:56 | **Përditesimi: 29 Tetor, 14:46**

Share

Elbasan- Një ngjarje e rëndë ndodhi sot në orët e para të mëngjesit (29 tetor) në Elbasan, ku 25 vjeçari Kristi Balukja, humbi jetën, pasi teksa po tentonte të vendosë një sasi eksplozivi në një makinë lënda i shpërtheu në dorë para kohe.

Rreth orës 04.10 të mëngjesit i riu shkoi në lagjen 'Shënkoll' për t'i vënë eksploziv në makinës tip "Volksëagen" në pronësi të Renato Çepës, rreth orës 04:10 të mëngjesit në lagjen "Shënkoll'.

Report Tv dhe Shqiptarja.com solli pamjet nga vendi ku ndodhi shpërthimi, ndërsa makina tip "Volkswagen" duket se është dëmtuar më totalisht në pjesën e përparme.

LEXO EDHE:
Protesta e opozitës/ 3 të arrestuar në Elbasan, 3 në kërkim! Në hetim 20 protestues dhe 3 deputetët të PD

Balukja pësoi dëme të shumta, të cilave nuk mundi t'u mbijetojë. Shënjestra Renato Çepa njihet në Elbasan dhe si "Kel Llumi" dhe pjesë e grupit të Emiljano Ramazanit, i ekzekutuar disa vite më parë.

Sipas policisë mes viktimës dhe autorit disa kohë më parë ka pasur një konflikt fizik dhe ngjarja e sotme besohet se lidhet pikërisht me këtë konflikt të ndodhur mes tyre.

> *"Në vijim të informacionit të dhënë mëngjesin e sotëm, ku si pasojë e shpërthimit të lëndës eksplozive, gjatë vënies së saj, në automjetin tip "Volkswagen" në pronësi të shtetasit Renato Çepa, në lagjen "Shënkoll", ishte dëmtuar autori, i cili humbi jetën në spital, ju informojmë se pas verifikimeve të kryera, është identifikuar ky shtetas, konkretisht Kristi Balukja, 25 vjeç, banues në Elbasan.*
>
> *Nga hetimet e deritanishme ka rezultuar se 25-vjeçari, për shkak të një konflikti të vjetër, për motive të dobëta, mëngjesin e sotëm, ka vënë lëndë eksplozive në automjetin e shtetasit Renato Çepa', njoftoi sot policia.*

Policia ka ngritur një grup të posaçëm hetimor me specialistë për Hetimin e Krimeve të Rënda të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan dhe Departamentit të Policisë Kriminale në drejtimin e Prokurorisë, të cilët vijojnë punën për zbardhjen e ngjarjes.

Foto: Makina të cilës iu vu eksplozivi

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:31

FOTO/ Ky është 25-vjeçari që vdiq pasi i shpërtheu tritoli në dorë

Foto: Kristi Balukja

Kristi Balukja, 25 vjeç, humbi jetën mëngjesin e kësaj të marte në Elbasan. Teksa po tentonte të vendosë një sasi eksplozivi në një makin lënda i shpërtheu në dorë para kohe. I riu rezulton pa precedentë të mëparshëm penal, por dyshohet se shkak u bë një konflikt i vjetër, për motive të dobëta mes shënjestrës së atentatit, Renato Çepa me të ndjerin.

Balukja pësoi dëme të shumta, të cilave nuk mundi t'u mbijetojë. Si pasojë e shpërthimit u dëmtua në pjesën e përparme edhe makina.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:54

Shpërthimi në Elbasan/ Identifikohet viktima, i vuri tritolin makinës së një tjetri i shpërtheu në dorë

Kristi Balukja, është i riu që humbi jetën mëngjesin e sotëm në qytetin e Elbasanit. Ai ka tentuar ti verë tritol makinës së Renato Çepa, por sasia e eksplozivit i ka plasur në dorë duke i marë jetën menjëherë.

Sipas policisë Renato Çepa njihet në Elbasan dhe si "Kel Llumi", duke shtuar se mes viktimës dhe autorit disa kohë më parë ka pasur një konflikt fizik.

Ngjarja e sotme besohet shumë se lidhet pikërisht me këtw konflikt të ndodhur disa kohë më parë mes Renato Çepa dhe Kristi Balukja. Tre muaj më parë nga sulmi me tritol në një pallat ku banonin motrat Nikolli në Elbasan mbeti i vrarë një njeri i pafajshëm siç ishte Enea Thomollari.

Njoftimi i policisë:

> *Elbasan/Informacion shtesë*
>
> *Në vijim të informacionit të dhënë mëngjesin e sotëm, ku si pasojë e shpërthimit të lëndës eksplozive, gjatë vënies së saj, në automjetin tip "Volksëagen" në pronësi të shtetasit Renato Çepa, në lagjen "Shënkoll", ishte dëmtuar autori, i cili humbi jetën në spital, ju informojmë se pas verifikimeve të kryera, është identifikuar ky shtetas, konkretisht Kristi Balukja, 25 vjeç, banues në Elbasan.*

Nga hetimet e deritanishme ka rezultuar se 25-vjeçari, për shkak të një konflikti të vjetër, për motive të dobëta, mëngjesin e sotëm, ka vënë lëndë eksplozive në automjetin e shtetasit Renato Çepa.
Lënda eksplozive ka shpërthyer gjatë vënies dhe si pasojë 25-vjeçari ka humbur jetën, në spital.

Një grup i posaçëm hetimor, i përbërë nga strukturat hetimore të DVP Elbasan dhe të Komisariatit të Policisë Elbasan, si dhe nga ekspertë të Departamentit të Policisë Kriminale në DPPSH, në drejtimin e Prokurorisë, vijon punën pët të zbardhur të gjitha rrethanat e këtij rasti.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 08:44

Humbi jetën pasi po i vendoste eksploziv një makine por i shpërtheu, ja pamjet nga mjeti i dëmtuar (VIDEO)

Shqiptarja. com dhe Report Tv, sjellin pamjet nga shpërthimi me **eksploziv** në Elbasan mëngjesin e sotëm, ku një 24- vjeçar, duke vendosur lëndë eksplozive në automjetin tip "Volksëagen", në pronësi të personit Renato Çepa, i shpërtheu eksplozivi dhe për pasojë humbi jetën.

Në pamjet e siguruara shihet momenti kur makina merret nga vendi ku ndodhi ngjarja me karrotrec.

Si pasojë e shpërthimit makina është dëmtuar totalisht në pjesën e përparme.

S.B/Shqiptarja.com

Share

S.B/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Emiljano Ramazani | kel llumi | humb jetën | eksploziv | Elbasan | Policia e Elbasanit | Renato Çepa | Kristi Balukja

Komento

Komente

Real: 29/10/2024 18:46

Po baluket i kishte krehur perpara apo ja krehu c4? Mentalitet i poshter agresiv dhe primitiv. Hetoni ku e gjeti c4, kush e ks ndihmuar dhe mbeshtetur dhe groposini dhe ata.

Përgjigju

Pupu: 29/10/2024 17:13

Mire, mire, por qellimit ja ka arritur...ja ka shkaterruar makinen Renatos!!

Përgjigju

mcn: 29/10/2024 14:24

o sa mire,, keshtu e PESOFSHIN TW GJITTHE ATA QE VENDOSIN EKSPLOZIV NE SHQIPTARE....

Përgjigju

Nino: 29/10/2024 13:23

O migo ktisti cuni i gon balukes nga njerzit me te pasur ne elbasan se kuptoj duke pas jeten e siguruar edhe me te gjitha tmirat iken e ngaterrohesh kot se koti iku kot gjith ai cun po kshu esht kur ske mend ne qe skemi themi te kishim leket e atij ca jete do banim ai iken edhe ben k##lluqe e vdes gjithsesi qoft i xhenetit sjemi askushi te gjykojm

Përgjigju

Tritoli: 29/10/2024 16:24

BUDALLAI E KA LIDHUR PARA, PASTAJ KA NDEZUR CELULARIN KA ARDH SMS NGA KONPANIA CELULARE " MIRSERDHE NË ALBANISATN KEMI OFERTA PËR TY" BO@OM....

Mario: 29/10/2024 16:07

Per te ardhur keq, qe nje djale i ri me te ardhura qe sipas jush nuk paska pasur nevoje te nxjerr buken e gojes, ne vend te merrej me gjera qe te permiresonte dicka me teper per vendin ku jeton, shkon dhe per nje zenke kerkon te vras dike tjeter. Me mire qe e ka hequr qe tani Zoti, se keshtu do te bente gjithmone.

O nin: 29/10/2024 13:49

Po aq i pasur paska qene ky. Si ka mundësi me te gjith ato te mira dhe pasuri do vinte tritol. Dhe nese do e vinte kur paska pas aq shume leke fare mire mund te porosiste e te paguante te tjere. Ka dicka qe nuk shkon

Pjeter: 29/10/2024 13:04

Karma

Përgjigju

Polici: 29/10/2024 12:57

Karma

Përgjigju

Or teeejjj: 29/10/2024 12:05

Me ne fund nje lajm pozitiv or tejjjj

Përgjigju

Alb: 29/10/2024 11:54

Brezi i demokracis.

Përgjigju

Tarrasi: 29/10/2024 10:39

Me ne fund nje lajmi mire

Përgjigju

Lala: 29/10/2024 12:13

NJËLLOJ SI AI BIZNESMENI QË SHPËRTHEU VETEN NË SARANDË NË MES TË DETIT, DUKE TENTUAR TJA VINTE NJE TRAGETI LINJE..... VETËM SE ATJE HYN VALËT E GREKUT,DHE THAM TË NA RROJË GREKU,SE KUSHEDI SA DO ISHTE TRAGJEDIA, PO KTU...?

Turi: 29/10/2024 10:19

Kot nuk kane thene te paret cfare te mbjellesh do te korresh , eshte vertet tragjedi qe djem te ri e kane mendjen te vrasin dhe jo te jetojne jeten

Përgjigju

tarja: 29/10/2024 10:01

hajde me kete te mbare. Legena njerez!

Përgjigju

Jovan bregu: 29/10/2024 10:00

Epo kesaj i thon tja japesh vetes bam..

Përgjigju

Juli: 29/10/2024 09:50

Iku dhe nje llum.I shkofte shpirti ne hale

Përgjigju

Per tu cuditur: 29/10/2024 09:42

Si nje djale i ri 24 vjec mendon te vej dinamit ne 4 te mjesit ! Me gjith keto mundesi qe jan krijuar leviz lirshem neper bot mund ta krijoj jeten kudo ne moshen me te mir , mendon te vej eksploziv naten !!! Shijen jeten o rini , ka mundesira pafund

Përgjigju

suel: 29/10/2024 09:18

Kot nuk thonë kush i bën varrin tjetrit bie vetë,kështu duhet ti ndodhi të gjith atyre që bëjnë krime të tilla.

Përgjigju

Njoni: 29/10/2024 09:10

Ja iku dhe nje hale tjeter. Nje hale me pak ne rruge ka zot atje larte. Keshtu u shperthefshin te gjithtgeve ishalla. Pacin fatin e ketij.

Përgjigju

Bravo: 29/10/2024 08:33

Kjo quhet vetpastrim

Përgjigju

Landi: 29/10/2024 08:28

ne jemi njerez me bisht kerkojme dhe Europe ne injorantet e europes

Përgjigju

Gazepi: 29/10/2024 08:26

Kesaj i thone o i shkreti kolonjar

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:

PD proteston duke bllokuar rrugët kryesore në vend, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Shkodër/ U përplas nga një mjet, humb jetën 62-vjeçari! Digjen 2 makina

30 Tetor, 08:22

Bllokimi tek rrethrrotullimi i Rrogozhinës, largohet një pjesë e qytetarëve

29 Tetor, 19:31

'O qelbësira', protestuesit përplasen me policinë edhe në Elbasan! Hapet rruga për qarkullim

29 Tetor, 19:18

Sherr mes adoleshentëve në Elbasan/ 14 vjeçari godet me thikë bashkëmoshatarin e tij

29 Tetor, 16:07

Tiranë/ U përplas nga një automjet, 63-vjeçarja ndërron jetë në spital

29 Tetor, 09:27

Makina 'Golf' përfshihet nga flakët në aksin Belsh-Kuçovë, s'ka të lënduar! Policia nis hetimet, mjeti digjet i gjithi (VIDEO)

27 Tetor, 18:36



Bullgaria mban sot zgjedhjet parlamentare! Qendrat e votimit janë hapur dhe në Tiranë, Elbasan, Korçë e Kukës

Benet Beqiri

27 Tetor, 10:59

Nuredin Dumani 14 vjet më parë me tufa parash në duar! Gazetari publikon fotot : Vrasësi që e nisi 'karrierën' si 'çerri' i Talo Çelës

27 Tetor, 09:04

Peqin/ Plagosje dy ditë më parë, policia arreston 50 vjeçarin pasi nuk kallëzoi krimin dhe fshehu dvr-n e kamerave të biznesit të tij! Autori ende në kërkim

26 Tetor, 13:30

Elbasan/ Kishte përshtatur lokalin për organizimin e lojërave të fatit, arrestohet 35-vjeçari dhe 9 të tjerë! Sekuestrohen çipsa pokeri, drogë e para

26 Tetor, 10:55

Elbasani mirëpret festivalin 'Qytete me Kala'

25 Tetor, 17:47



Peqin/ Plagosi në këmbë me armë zjarri një person, policia po punon për kapjen e autorit

24 Tetor, 22:58

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje